

V E N D I M
Nr. 380, datë 12.8.1999

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT
TË MINISTRAVE NR. 32, DATË 25.1.1999 “PËR DHËNIEN NË
ENFITEOZË TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇELIKUT ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8333, datë 23.4.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 32, datë 25. 1. 1999 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 të ndryshohet si vijon:

“Përfshihet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 9.7.1998 “Për dhënie me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore”, të ardhurat nga shpërblimi periodik mujor i kësaj kontrate të përdoren tërësisht (100 për qind), për një periudhë dy vjeçare, për trajtimin financiar të punonjësve që dalin të papunë nga lidhja e kësaj kontrate”.

2. Pas pikës 2 të shtohet pika 2/1 si vijon:

“Pas dy viteve të para, të ardhurat e kësaj kontrate do t’i nënshtrohen kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 9.7.1998 “Për dhënie me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore””.

3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko